



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1784/prot.
6

Elbasan, me 13.07.2022

VENDIM

Nr 27 datë 13.07.2022

Për

**shtesa dhe ndryshime në VBA-së nr. 53, datë 31.12.2021 "Për
ulje tarife vjetore të shkollimit të studentëve në Ciklin e dytë të studimeve, për program të parë
studimi, për vitin akademik 2021-2022."**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM-së Nr. 780, datë 26.12.2018 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë", i ndryshuar, Vendimeve të Bordit të Administrimit nr 40 datë 02.11.2021 "Për procedurën e aplikimit të studentëve në Ciklin e dytë të studimit për ulje nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin 2021-2022", nr 41 datë 02.11.2021 "Për ngritjen e komisionit për përpunim të dhënash e dokumentacioni për përfitim ulje nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2021-2022", Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

- 1- Përfitojnë ulje tarife shkollimi 72 studentë me rezultate (mesatare 9-10-të) brenda kohëzgjatjes normale të periudhës së studimit (shtohet 1 studentë me rezultate të verifikuara nga sqarimet e studentëve), sipas listës bashkëlidhur.
- 2- Përfitojnë ulje tarife shkollimi 250 studentë me kriteret e tjera mbas konfirmimit të statusit të tyre dhe verifikimit (shtohet 1 student me kriteret e tjera, i cili është skualifikuar në vendimin e mëparshëm pasi), sipas listës bashkëlidhur.
- 3- Nuk përfitojnë ulje tarife shkollimi 49 studentë nga 38 studentë të miratuar në vendimin e mëparshëm nr 53 datë 31.12.2021 për arsye të mosplotësimit të kriterëve të përcaktuara, konfirmimeve nga institucionet përkatëse dhe aplikimit të tyre jashtë afatit të përcaktuar në VKM, (hiqet 1 studente nga lista e VBA-së nr 19 datë 14.05.2022) sipas listës bashkëlidhur.
- 4- Për rastet që mund të evidentohen ndryshime në statusin e tyre apo të mosplotësimit të kriterëve të studentëve sipas listës në pikën 1, 2 të mos zbatohet vendimarrja e përfitimit

KRYETARI I BORDIT
ARDIAN DËRMISHI

